



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1630/1 Prot

Tiranë, më 05.12.2019

V E N D I M

Nr.152, datë 05.12.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Tepelenë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Tepelenë,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019 “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Tepelenë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Tepelenë, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 4, datë 11.03.2019, të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë 2019”, në zbatim të vendimit

nr. 76, dat 28.12.2019, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Tepelenë”, strukturë e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas kësaj strukture, Bashkia Tepelenë së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **40** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion i nivelit të lartë drejtues, **6** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **2** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **31** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Në strukturën organizative të Bashkisë Tepelenë, Komisioneri ka konstatuar një qëndrim jo të unifikuar ndaj pozicioneve të shërbimit civil, që janë pjesë e strukturës së njësive administrative, pasi rezulton që, pozicionet e punës me funksionet e ndihmës ekonomike, pranë njësive administrative, në disa raste paraqiten me emërtesën “*Specialist i ndihmës ekonomike*” dhe në raste të tjera, paraqiten me emërtesën “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”.

Në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, vlerësohet se trajtimi dhe përfshirja e një pozicioni pune në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, duhet të analizohet duke e lidhur me detyrat dhe funksionet e pozicionit konkret, kjo në referencë të ushtrimit të autoritetit publik, në drejtim të formulimit dhe zbatimit të politikave, monitorimin e zbatimit të procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimit të mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Në këto kushte, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tepelenë, me miratimin e strukturës së ardhshme, duhet të analizojë detyrat dhe kompetencat për pozicionet e punës, që janë pjesë e strukturës së njësive administrative dhe në përfundim të këtij procesi të vendosë përfshirjen ose jo të këtyre pozicioneve në shërbimin civil.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt u konstatua se, **13** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **19** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë së aktualisht janë plotësuar me punonjës të emëruar me akt të përkohshëm emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, ndërsa **8** pozicione rezultuan të lira.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, Përgjegjës i Sektorit të Integritimit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 16/1, datë 12.03.2019;
2. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Integritimit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 16/1, datë 12.03.2019;
3. *****, “*Specialist protokoll*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Biblioteke Publike, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative, emëruar me aktin nr. 36/1, datë 02.05.2018;
4. *****, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Kujdesit Social, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative, emëruar me aktin nr. 36/1, datë 02.05.2018;
5. *****, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, emëruar me aktin nr. 17, datë 12.03.2019;
6. *****, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe kujdesit Social, emëruar me aktin nr. 4/1, datë 11.03.2018;
7. *****, Drejtor i Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr. 4/1, datë 11.03.2019;
8. *****, Specialist i emergjencave civile, në Sektorin e Mjedisit dhe Turizmit, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 51, datë 10.07.2019;
9. *****, “*Specialist i mjedisit dhe emergjencës civile*”, në Sektorin e Mjedisit dhe Turizmit, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 56, datë 17.04.2017;
10. *****, “*Specialist i Mbrojtjes së Konsumatorit*”, në Sektorin e Veterinarisë, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar nëpërmjet miratimit të strukturës organizative me urdhrin nr. 36/1, datë 02.07.2018;
11. *****, “*Specialist veteriner*”, në Sektorin e Veterinarisë, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 16/1, datë 06.04.2016;
12. *****, “*Specialist pyjesh*”, në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 4/1, datë 11.03.2019;
13. *****, “*Specialist*”, në Njësinë Administrative Kurvelesh, emëruar me aktin nr. 16, datë 06.04.2016;
14. *****, Specialist në Njësinë Administrative Kurvelesh, emëruar me aktin nr. 16, datë 06.04.2016;
15. *****, Specialist në Njësinë Administrative Lopës, emëruar me aktin nr. 36/1, datë 02.07.2018;
16. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Tokës dhe Ujërave, emëruar me aktin nr. 50, datë 10.07.2019;
17. *****, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në Njësinë Administrative Kurvelesh, mungon aktin i emërimit për këtë pozicion (*sipas aktit nr. 145, datë 01.06.2016, emëruar në pozicionin “Specialist shërbimesh”, në Njësinë Administrative Kurvelesh*);

18. *****, “*Specialist*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pranë Bashkisë Tepelenë, emëruar me aktin nr. 8, datë 09.04.2014;
19. *****, “*Specialist*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pranë Bashkisë Tepelenë, emëruar me aktin nr. 49, datë 03.04.2017.

Komisioneri konstaton se, aktet e mësipërme të emërimit, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi në bazë të neneve 22 – 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pranimet në shërbimin civil duhen bërë, duke respektuar detyrimisht një procedurë të rregullt konkurrimi. Çdo akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me këtë rregull, në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, është absolutisht i pavlefshëm. Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, për pozicionet e nivelit ekzekutiv, është theksuar shprehimisht edhe në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Tepelenë, duhet të evidentojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart dhe të konstatojë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve, shoqëruar kjo me përcaktimin e masave për rregullimin e pasojave duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, shpalljen e këtyre pozicione vakante për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **19** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, që janë:

- ✓ ***** , Përgjegjës i Sektorit të Integritimit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 16/1, datë 12.03.2019;
- ✓ ***** , “Specialist”, në Sektorin e Integritimit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 16/1, datë 12.03.2019;
- ✓ ***** , “Specialist protokollit”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Biblioteke Publike, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative, emëruar me aktin nr. 36/1, datë 02.05.2018;
- ✓ ***** , “Specialist i ndihmës ekonomike”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Kujdesit Social, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative, emëruar me aktin nr. 36/1, datë 02.05.2018;
- ✓ ***** , “Specialist”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, emëruar me aktin nr. 17, datë 12.03.2019;
- ✓ ***** , Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe kujdesit Social, emëruar me aktin nr. 4/1, datë 11.03.2018;
- ✓ ***** , Drejtor i Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr. 4/1, datë 11.03.2019;
- ✓ ***** , Specialist i emergjencave civile, në Sektorin e Mjedisit dhe Turizmit, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 51, datë 10.07.2019;
- ✓ ***** , “Specialist i mjedisit dhe emergjencës civile”, në Sektorin e Mjedisit dhe Turizmit, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 56, datë 17.04.2017;
- ✓ ***** , “Specialist i Mbrojtjes së Konsumatorit”, në Sektorin e Veterinarisë, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar nëpërmjet miratimit të strukturës organizative me urdhrin nr. 36/1, datë 02.07.2018;

- ✓ ***** , “*Specialist veteriner*”, në Sektorin e Veterinarisë, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 16/1, datë 06.04.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist pyjesh*”, në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 4/1, datë 11.03.2019;
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Njësinë Administrative Kurvelesh, emëruar me aktin nr. 16, datë 06.04.2016;
- ✓ ***** , Specialist në Njësinë Administrative Kurvelesh, emëruar me aktin nr. 16, datë 06.04.2016;
- ✓ ***** , Specialist në Njësinë Administrative Lopës, emëruar me aktin nr. 36/1, datë 02.07.2018;
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Tokës dhe Ujërave, emëruar me aktin nr. 50, datë 10.07.2019;
- ✓ ***** , “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në Njësinë Administrative Kurvelesh, mungon aktin i emërimit për këtë pozicion (*sipas aktit nr. 145, datë 01.06.2016, emëruar në pozicionin “Specialist shërbimesh”, në Njësinë Administrative Kurvelesh*);
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pranë Bashkisë Tepelenë, emëruar me aktin nr. 8, datë 09.04.2014;
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pranë Bashkisë Tepelenë, emëruar me aktin nr. 49, datë 03.04.2017.

dhe të rregullohen pasojat duke i shpallur këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin.

2. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit aktualisht janë vakante ose rezultojnë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të shpallë konkurrimin për t’i plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit.
3. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë deri në shkurt të vitit 2020, planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për pozicionet e mbetura vakant, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.
4. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tepelenë, në momentin e miratimit të strukturës së ardhshme për vitin 2020, të tregoj kujdes në krijimin e një strukture, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke vepruar si më poshtë:

- ✓ Për pozicionet e punës pjesë e strukturës organizative të njësive administrative, të cilat kryejnë funksionet e ndihmës ekonomike dhe në strukturë paraqiten me emërtesën “*Specialist i ndihmës ekonomike*” dhe “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, të analizojë detyrat, funksionet dhe kompetencat përkatëse, nëpërmjet procesit të hartimit të përshkrimeve të punës dhe në përfundim të këtij procesi të vendosë përfshirjen e këtyre pozicione ose jo, në skemën e shërbimit civil.
5. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes, i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 79, datë 13.07.2016, të Komisionerit “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 332 prot., datë 18.04.2016*” dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të vendimit paralajmërues për këtë institucion.
 6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Tepelenë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
 7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
 8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Tepelenë, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Tepelenë, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Gjirokastër. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tepelenë të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha